


Rregullatorë presioni me vetë-operim

Valvul reduktimi presioni e tipit 2422/2424

SAMSON



Valvul reduktimi presioni e tipit 2422/2424

Udhëzimet e montimit dhe operimit

EB 2547 SQ

Edicioni Mars 2014



Përkufizimi i fjalëve të sinjaleve



RREZIK!

Situata të cilat, nëse nuk shmangen, do të çojnë në vdekje ose lëndime serioze



PARALAJMËRIM!

Situata të rrezikshme të cilat, nëse nuk shmangen, mund të çojnë në vdekje ose lëndime serioze



NJOFTIM

Mesazh për dëmtim të pronës ose defekt



Shënim:

Informacione shtesë



Këshillë:

Veprimi i rekomanduar

1	Udhëzime të përgjithshme	4
2	Materiali i procesit dhe shtrirja e aplikimit.....	5
2.1	Transporti dhe ruajtja	5
3	Ndërtimi dhe parimi i operimit.....	6
4	Instalimi.....	8
4.1	Montimi	8
4.2	Pozicioni i montimit.....	9
4.3	Shënime mbi instalimin.....	9
4.4	Linja e kontrollit, dhoma e kondensimit dhe valvula me gjilpërë	10
4.5	Sita.....	11
4.6	Valvula e mbylljes	11
4.7	Matësit e presionit.....	11
5	Operimi.....	12
5.1	Vënia në punë	12
5.2	Rregullimi i pikës së caktuar.....	12
5.3	Heqja nga puna	13
6	Mirëmbajtja dhe zgjidhja e problemeve	13
6.1	Ndërrimi i diafragmës së operimit.....	13
7	Etiketa e të dhënave	14
8	Shërbimi për klientin	15
9	Përmasat	16
10	Të dhëna teknike	18



1 Udhëzime të përgjithshme

- Rregullatori duhet të montohet, vihet në punë ose riparohet vetëm nga personeli i trajnuar dhe kualifikuar plotësisht; duhet të zbatohen kodet dhe praktikat e pranuarat të industrisë. Sigurohuni që punonjësit ose personat e tretë të mos jenë të ekspozuar ndaj asnjë rreziku.
- Të gjitha udhëzimet dhe paralajmërimet e sigurisë të dhëna në këto udhëzime montimi dhe operimi, sidomos ato në lidhje me instalimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen, duhet të zbatohen rreptësisht.
- Sipas këtyre udhëzimeve të montimit dhe operimit, personeli i trajnuar i referohet individëve të cilët janë në gjendje të gjykojnë punën që u është caktuar dhe të dallojnë rreziqet e mundshme në sajë të trajnimit të tyre të specializuar, njohurisë dhe përvojës së tyre, si edhe njohurisë për standardet që zbatohen.
- Rregullatorët i përmbahen kërkesave të direktivës evropiane 97/23/EC për pajisjet e presionit. Deklarata e konformitetit e lëshuar për një rregullator me markën CE përfshin informacione mbi procedurën e vlerësimit të konformitetit. Deklarata e konformitetit është e disponueshme me kërkesë.
- Për të garantuar përdorim të përshtatshëm, përdoren rregullatorin vetëm në aplikime ku presioni dhe temperaturat e operimit nuk i kalojnë specifikimet e përdorura për madhësinë e rregullatorit në fazën e porositisjes.
- Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtimet e shkaktuara nga forcat e jashtme ose ndonjë faktor tjetër i jashtëm.
- Çdo rrezik që mund të shkaktohet në rregullator nga materiali i procesit, presioni i operimit ose pjesët e lëvizshme duhet të parandalohet duke marrë masat paraprake të përshtatshme.
- Supozohet që të bëhet transporti, ruajtja, instalimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e duhur.



Shënim:

Versionet jo-elektrike të aktuatorëve dhe valvulave të kontrollit nuk kanë burimin e tyre të ndezjes me energji sipas vlerësimit të rrezikut për marrjen flakë të përcaktuar në EN 13463-1:2009, pjesa 5.2, edhe në rastin e rrallë të një defekti në punim. Prandaj ato nuk bien brenda shtirirjes së direktivës 94/9/EC.

Për lidhjen me sistemin ekuipotencial, zbatoni kërkesat e përcaktuara në pjesën 6.3 të EN 60079-14 (VDE 0165 Pjesa 1).

2 Materiali i procesit dhe shtrirja e aplikimit

Rregullatori i presionit për lëngjet, gazrat dhe avujt deri në 350 °C

Për kontrollimin e presionit të rrjedhës së poshtme p2 në pikën e caktuar të rregulluar. Valvula mbyllet kur presioni i rrjedhës së poshtme rritet. Presioni i rrjedhës së poshtme transmetohet në aktuator në një linjë kontrolli që duhet të instalohet në vend.

Rregullatorët e presionit janë pajisje mbylljeje që garantojnë mbyllje të fortë. Kur mbyllen, këta rregullatorë kanë një vlerë rrjedhjeje prej $\leq 0.05\%$ të koeficientit Kvs.

Mbrojtja e presionit të lartë duhet të instalohet në impiant.



PARALAJMËRIM!

Presioni i tepërt i pakontrolluar në impiant mund të dëmtojë diafragmën dhe mund të çojë në lëndime personale.

Presioni maksimal i lejuar në aktuator nuk duhet të kalojë presionin e specifikuar në tabelën tabelën 1.

2.1 Transporti dhe ruajtja

Rregullatori duhet të kapet, transportohet dhe ruhet me kujdes. Mbrojeni rregullatorin nga ndikimet e dëmshme si papastërtitë, lagështia ose ngrica para se të montohet.

Kur rregullatorët janë shumë të rëndë për t'u ngritur me dorë, shtrëngoni rripin e ngritjes në një vend të përshtatshëm në trupin e valvulës.



PARALAJMËRIM!

Rrezik lëndimi për shkak të rrëzimit të valvulës!

Shtrëngoni rripin e ngritjes vetëm në trupin e valvulës dhe sigurojeni të mos rrëshqasë.

3 Ndërtimi dhe parimi i operimit

Shiko Fig. 1 dhe Fig. 2.

Valvula e reduktimit të presionit e tipit 2422/2424 përbëhet nga valvula e tipit 2422 dhe aktuatori i tipit 2424. Valvula e tipit 2422 është e disponueshme qoftë e balancuar me një shakull ose diafragmë. Valvula e reduktimit të presionit përdoret për të ruajtur presionin në rrjedhën e poshtme të valvulës në një pikë të caktuar të rregulluar. Valvula mbyllet kur presioni i rrjedhës së poshtme rritet.

Materiali rrjedh në valvul në drejtimin e treguar nga shigjeta. Pozicioni i tapës (3) përcakton shpejtësinë e rrjedhës në vendin e liruar midis tapës dhe ndenjësës së valvulës (2). Boshti i tapës (4) me tapën është i lidhur me boshtin e aktuatorit (4.1) të aktuatorit (10).

Presioni i rrjedhës së poshtme p2 rregullohet në sustat e pozicionimit (11) dhe rregullatorin e pikës së caktuar (13). Kur lirohet nga presioni ($p_1=p_2$), valvula hapet nga forca e sustave të pozicionimit.

Presioni i rrjedhës së poshtme p2 për t'u kontrolluar mbyllet në rrjedhën e poshtme të valvulës dhe transmetohet në linjën e kontrollit në diafragmën e operimit (9) ku konfertohehet në një forcë pozicionimi. Kjo forcë përdoret për të lëvizur tapën e valvulës sipas forcës së sustave të pozicionimit. Kur forca që rezulton nga presioni i rrjedhës së poshtme p2 rritet mbi pikën e caktuar të rregulluar, valvula mbyllet në proporcion me ndryshimin e presionit.

Parimi i operimit të valvulës së reduktimit të presionit e tipit 2422/2424 e balancuar me shakull ose diafragmë ndryshon vetëm në lidhje me balancimin e presionit. Valvulat e balancuara nga një diafragmë kanë një diafragmë balancimi (5.2) në vend të një shakulli (5). Në të dyja rastet, forcat e krijuara nga presionet e rrjedhës së sipërme dhe rrjedhës së poshtme që veprojnë në tapën e valvulës balancohen.

Valvulat mund të pajisen me ndarës rrjedhe St I ose St III. Foleja e valvulës duhet të ndërrohet kur shtohet ndarësi i rrjedhës.


Kontrolli i **avullit dhe lëngjeve** mbi **150 °C** është i mundur vetëm me një valvul të tipit 2422 të balancuar me një shakull. Në këtë rast, dhoma e kondensimit (20) është instaluar tashmë në linjën e kontrollit 1). Valvula me gjilpërë (18) hapet dhe izolohet me plumb.

Para vënies në punë, mbusheni dhomën e kondensimit me materialin e procesit në hapësirën e mbushjes sipër.

¹⁾ Vetëm në kombinim me një kit linje kontrolli. Përndryshe, dhoma e kondensimit duhet të porositet veçmas (shiko ► T 2595).


Valvula e tipit 2422 e balancuar nga një shakull

Aktuatori i tipit 2424



- | | | | | | |
|-----|---|-----|---------------------------------|-------|--|
| 1 | Valvula e tipit 2422 | 8,1 | Dado | 18 | Lidhja e linjës së kontrollit (për avull që përfshin bashkimin me vidë me valvul kufizimi me ndalim dhe valvul gjilpërë) |
| 2 | Foleja (e shkëmbyeshme) | 9 | Diafragma e operimit | 19 | Linja e kontrollit |
| 3 | Tapa | 10 | Aktuatori i tipit 2424 | 20 | Dhoma e kondensimit për temperaturat mbi 350 °C dhe për avull |
| 4 | Boshti i tapës | 11 | Sustat e pozicionimit | 21 | Tapa e mbushjes |
| 4,1 | Boshti i aktuatorit | 13 | Rregullatori i pikës së caktuar | p_1 | Presioni i rrjedhës së sipërme |
| 5 | Shakulli i balancimit | 14 | Boshti i diafragmës së poshtme | p_2 | Presioni i rrjedhës së poshtme |
| 6 | Trupi i shakullit | 15 | Dadot dhe bulonat | | |
| 6,1 | Vida e shfryrjes (trupi i shakullit) | 16 | Dado | | |
| 6,2 | Vida e shfryrjes (lidhja me aktuatorin) | 17 | Pllaka e diafragmës | | |
| 7 | Dado bashkimi | | | | |
| 8 | Boshti i diafragmës së sipërme | | | | |

Fig. 1: Diafragma funksionale e tipit 2422/2424 e balancuar nga një shakull



4 Instalimi

Shiko Fig. 1 dhe Fig. 2.

4.1 Montimi

Valvula dhe aktuatori mund të montohen para ose pasi të jetë instaluar valvula në tubacino.

→ Lironi nga tensioni sustat e pozicionimit duke rrotulluar rregullatorin e pikës së caktuar (13).

- Vendoseni aktuatorin mbi trupin e shakullit dhe vidhoseni me kujdes aq sa të shkojë. Sigurohuni që lidhja e linjës së kontrollit të drejtohet drejt anës së presionit të rrjedhës së poshtme.
- Mbani aktuatorin dhe shtrëngojeni në trupin e shakullit duke përdorur dadon e bashkimit (7).

4.2 Pozicioni i montimit


Zgjidhni vendin e instalimit duke u siguruar që rregullatori të instalohet në një distancë prej të paktën gjashtë herë më shumë se madhësia nominale (DN) larg nga pjesët e tubacionit ose instrumentet që shkaktojnë turbulencë rrjedhe (p.sh. përthyerje tubi, manikota, pika të matjes së presionit ose valvula të tjera). Ato mund të ndryshojnë kushtet e rrjedhës të cilat mund të çojnë në proces kontrolli të paqëndrueshëm sidomos në aplikimet me gazra, ajër ose avull.

Kontaktoni SAMSON për të marrë dokumentacionin e TV-SK 17041 i cili përmban më shumë detaje mbi kërkesat e instalimit.

4.3 Shënime mbi instalimin

Instaloni valvulën e reduktimit të presionit në tubacione horizontale

- Shpëlani mirë tubacionet para se të instaloni rregullatorin për t'u siguruar që asnjë papastërti të mos pengojë funksionimin e mirë të valvulës, mbi të gjitha, mbylljen e mirë.
- Drejtimi i rrjedhës duhet të përputhet me drejtimin e treguar nga shigjeta në trup.
- Instaloni rregullatorin pa tension. Nëse është e nevojshme, mbështeteni tubacionin pranë flanxhave të lidhjeve. Mos lidhni mbajtëse direkt në valvul ose aktuator.
- Instaloni një sitë në rrjedhën e sipërme të rregullatorit.
- Mbrojeni rregullatorin nga ngrirja kur kontrolloni material që mund të ngrijë. Nëse është e nevojshme, hiqni presionin dhe zbrazeni rregullatorin dhe hiqeni nga tubacioni kur mbyllet impianti.



Pozicioni i montimit

Valvula e balancuar nga një shakull/diafragmë

- Aktuatori i drejtuar poshtë



Testimi i presionit të impiantit. Presioni nuk duhet të kalojë presionin maksimal të lejuar të rregullatorit dhe impiantit në testimin e presionit të impiantit kur rregullatori është i instaluar tashmë. Një presion testi tepër i lartë mund të dëmtojë diafragmën e operimit në aktuator.



PARALAJMËRIM!

Presioni i tepërt i pakontrolluar në impiant mund të dëmtojë diafragmën dhe mund të çojë në lëndime personale. Presioni maksimal i lejuar në aktuator nuk duhet të kalojë presionin e specifikuar në tabelën 1.

Tabela 1: Presioni maksimal i lejuar në aktuator

Sipërfaqja e aktuatorit	Presioni maksimal i aktuatorit
640 cm ²	1.5 bar
320 cm ²	3 bar

Për të parandaluar dëmtimet në diafragmë, merrni një nga masat paraprake të mëposhtme:

- Hiqni rregullatorin nga tubacioni ose izoloni rregullatorin në tubacion dhe instaloni një bajpas (shiko Fig. 3) ose
- Shkëputni linjën e kontrollit dhe mbyllni hapësirat me tapat fundore ose
- Instaloni një valvulë mbylljeje në linjën e kontrollit.

4.4 Linja e kontrollit, dhoma e kondensimit dhe valvula me gjilpërë

Linja e kontrollit : Duhet të sigurohet një linjë kontrolli në vendin e instalimit, p.sh. një tub 3/8" për avull ose një tub bakri Ø8 x 1 ose Ø6 x 1 mm për ajër/ujë.

Lidhni linjën e kontrollit me linjën e rrjedhës së poshtme (p2) të paktën një metër larg nga dalja e valvulës. Nëse ka një manikotë në rrjedhën e poshtme të presionit, lidhni valvulën me manikotën edhe nëse është disa metra larg. Nëse linja e rrjedhës së poshtme mbrapa valvulës është e zgjatur me një pjesë ekspansioni konike, lidhni linjën e kontrollit në pjesën e ekspansionit të linjës. Saldoni linjën e kontrollit në nën në mes të tubit duke e ngritur në një raport prej rreth 1:10 deri në dhomën e kondensimit.

Saldoni linjën që vjen nga pika e lidhjes në fletën e tubit 3/8" në dhomë. Instaloni dhomën e kondensimit në pikën më të lartë të tubacionit. Si rrjedhojë, linja e kontrollit midis dhomës së kondensimit dhe aktuatorit duhet të instalohet gjithashtu me një pjerrësi për poshtë. Në këtë rast, përdorni një tub 3/8" me pjesë vidhosjeje të reja.

Nëse linja e kontrollit ndodhet poshtë mesit të flanxhës së daljes së valvulës, rregulloni dhomën e kondensimit në të njëjtin nivel si flanxa e daljes. Në këtë rast, përdorni një tub i cili është të paktën 1/2" për linjën e kontrollit nga pika e lidhjes në dhomën e kondensimit. Nëse linja e kontrollit është e lidhur sipër mesit të flanxhës së daljes së valvulës, instaloni dhomën e kondensimit në të njëjtin

nivel si pika lidhjes të presionit të poshtëm. Presioni shtesë i kokës së kondensimit duhet të kompensohet duke rregulluar pikën e caktuar në një vlerë më të lartë.

Kiti i linjës së kontrollit · Një kit linje kontrolli për presionin e lidhjes direkt në trupin e valvulës është i disponueshëm si pjesë aksesorësh nga SAMSON (për pikat e caktuara ≥ 0.8 bar).

Dhoma e kondensimit · Nevojitet një dhomë kondensimi për lëngjet mbi 150 °C si edhe për **avullin**. Pozicioni i montimit të dhomës së kondensimit është treguar me një etiketë ngjitëse mbi vetë dhomën si edhe me një shigjetë dhe fjalën "top" të stampuar sipër dhomës.

Ky pozicion montimi duhet zbatuar; përndryshe nuk mund të garantohet funksionimi i sigurt i valvulës së reduktimit të presionit.

Valvula me gjilpërë · Nëse rregullatori ka prirjen të lëvizë, instaloni një valvulë me gjilpërë në lidhjen e linjës së kontrollit (18) përveç bashkimit standard me vidhosje SAMSON me kufizim.

4.5 Sita

Instaloni sitën në rrjedhën e sipërme të valvulës së reduktimit të presionit (shiko Fig. 3).

- Drejtimi i rrjedhës duhet të përkasë me shigjetën në trup.
- Elementi i filtrit duhet të instalohet për t'u varur poshtë ose anash për aplikimet me avull.



Këshillë:

Mos harroni të lini hapësirë të mjaftueshme për të hequr elementin e filtrit.

4.6 Valvula e mbylljes

Instaloni një valvulë mbylljeje që operohet me dorë në rrjedhën e sipërme të sitës dhe në rrjedhën e poshtme të rregullatorit. Kjo lejohet që impianti të mbyllet për punë pastrimi dhe mirëmbajtjeje dhe kur impianti nuk përdoret për periudha të gjata (shiko Fig. 3).

4.7 Matësit e presionit

Instaloni një matës presioni në rrjedhën e sipërme dhe rrjedhën e poshtme të rregullatorit për të monitoruar presionet që mbizotërojnë në impiant (shiko Fig. 3).

Instaloni matësin e presionit në anën e rrjedhës së poshtme mbrapa pikës së lidhjes së presionit në rrjedhën e poshtme.

5 Operimi

Shiko Fig. 1 dhe Fig. 2.

5.1 Vënia në punë

Vëreni në punë për herë të parë rregullatorin pasi të keni montuar të gjitha pjesët. Sigurohuni që linja e kontrollit të jetë e hapur dhe e lidhur mirë.

Mbusheni impiantin me ngadalë me materialin e procesit. Shmangi goditjet e papritura të presionit. Hapni në fillim valvulat e mbylljes në anën e presionit të rrjedhës së sipërme. Pas kësaj, hapni të gjitha valvulat në anën e konsumatorit (rrjedha e poshtme e rregullatorit).

Rregullimi i avullit

Mbani parasysh pikat e mëposhtme për aplikimet me avull:

- Para vënies në punë, të gjithë tubat që përcjellin materialin e procesit duhet të zbrazen komplet dhe të thahen (për të parandaluar goditjen e avullit).
- Para vënies në punë, mbusheni dhomën e kondensimit me ujë në hapësirën e mbushjes (21) derisa të derdhet. Vendosni përsëri tapën.
- **Vëreni** impiantin në punë me ngadalë dhe lini kohë që tubat dhe valvulat të ngrohen.

Ajri dhe kondensimi duhet të lihen të shkarkojnë nga impianti. Instaloni një bllokues avulli (p.sh. SAMSON Tipi 13 E) ose vrimë ajri për sistemet e operuara me avull (p.sh. SAMSON tipi 3) në një vend të përshtatshëm.

Rregullimi i lëngjeve

Për të vënë në punë valvulën e reduktimit të presionit, hapni me ngadalë valvulat e mbylljes.

Kur përdoret një aktuator 640 cm², zhvidhosni vidën e shfryrjes (6.1) për të lejuar që të dalë ajri dhe pastaj shtrëngoni përsëri vidën.

Për temperaturat mbi 150 °C, në fillim mbushni dhomën e kondensimit me materialin e procesit.

5.2 Rregullimi i pikës së caktuar

Rregulloni presionin e nevojshëm të rrjedhës së poshtme duke rrotulluar rregullatorin e pikës së caktuar (13).

Rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës ↻

- Presioni i rrjedhës së poshtme rritet (pika e caktuar e presionit më e lartë)

Rrotullojeni në drejtim të kundërt të akrepave të orës ↻

- Presioni i rrjedhës së poshtme ulet (pika e caktuar e presionit më e ulët)

Kur forca që vjen nga presioni i rrjedhës së poshtme p2 rritet mbi pikën e caktuar të vendosur, valvula mbyllet në proporcion me ndryshimin e presionit.



Këshillë:

Monitoroni presionin e pikës së caktuar në matësin e presionit në anën e presionit të rrjedhës së poshtme.

Ndryshimi i gamës së pikës së caktuar

Gama e pikës së caktuar përcaktohet nga madhësia e aktuatorit dhe e sustave të pozicionimit. Gama e pikës së caktuar mund të ndryshohet vetëm nga ndërrimi i të gjithë aktuatorit. Prandaj, rekomandojmë që të na kontaktoni nëse doni të ndryshoni gamën e pikës së caktuar.

5.3 Heqja nga puna

Në fillim mbyllni valvulën e mbylljes në anën e rrjedhës së sipërme të valvulës dhe pastaj në anën e rrjedhës së poshtme të valvulës.

6 Mirëmbajtja dhe zgjidhja e problemeve

Nëse presioni i rrjedhës së poshtme devijon ndjeshëm nga pika e caktuar, kontrolloni linjën e presionit për bllokime dhe kontrolloni diafragmën për rrjedhje.

Në rast të shkaqeve të tjera, si për shembull një fole ose tapë e dëmtuar, rekomandojmë të kontaktoni shërbimin e klientit të SAMSON (shiko pjesën 8).

Nëse diafragma është dëmtuar, veproni siç përshkruhet në pjesën 6.1.



PARALAJMËRIM!

Materiali i nxehtë i procesit mund të dalë jashtë i pakontrolluar gjatë çmontimit të rregullatorit. Rrezik për vëlmi.

Lini që rregullatori të ftohet para se të hiqni presionin dhe ta zbrazni dhe pastaj hiqeni nga tubacioni.

6.1 Ndërrimi i diafragmës së operimit

Shiko Fig. 1 dhe Fig. 2.

Mbylleni impiantin duke mbyllur me ngadalë valvulat e mbylljes. Hiqni presionin e pjesës përkatëse të tubacionit dhe, nëse është e nevojshme, zbrazeni edhe atë.

Aktuatori mund të hiqet nga valvula pa pasur nevojë për të hequr valvulën nga tubacioni. Sidoqoftë, në këtë rast, mos harroni se koni i aktuatorit liron trupin e shakullit. Si pasojë, materiali i procesit do të zbrazet nga valvula pas heqjes së aktuatorit.


1. Lironi nga tensioni pjesën e sustës duke rrotulluar rregullatorin e pikës së caktuar (13) në drejtim të kundërt të akrepave të orës.
2. Zhvidhosni linjën e kontrollit dhe pastrojeni.
3. Zhvidhosni dadon bashkuese (7) dhe hiqeni aktuatorin.
4. Zhvidhosni rregullatorin e pikës së caktuar (13). Hiqni kushinetën, unazën, sustën(at) dhe pllakën e sustës.
5. Zhvidhosni dadot dhe bulonat (15). Ngrini kapakun e sipërm nga boshti i aktuatorit.
6. Tërhiqni së bashku boshtet e diafragmës me pllakat e diafragmës dhe diafragmën nga kasa e poshtme e diafragmës.
7. Mbani dadon e poshtme (16) të palëvizur duke përdorur një çelës dhe zhvidhosni boshtin e sipërm të diafragmës duke liruar dadon (8.1) (dadoja është e izoluar nga boja!).
8. Nxirrni pllakën e sipërme të diafragmës (17). Ndërroni diafragmën e operimit (9) me një të re.

Veproni në radhë të kundërt për të montuar përsëri rregullatorin. Për vënien në punë, veproni siç tregohet në pjesën 5.1.


7 Etiketa e të dhënave

Etiketat e të dhënave janë ngjitur në valvul dhe në aktuator.

Etiketa e të dhënave të valvulës



Versioni DIN



Versioni ANSI


Versioni DIN

- 1 Tipi i valvulës
- 2 Numri i modelit me indeks
- 3 Konfigurimi (Var.-ID)
- 4 Numri ose data e porosisë
- 5 Koefficienti K_{VS}
- 7 Forca e sustës/gama e pikës së caktuar
- 8 Madhësia nominale
- 9 Presioni nominal
- 10 Presioni diferencial i lejuar
- 11 Temperatura e lejuar
- 12 Materiali i trupit

Versioni ANSI

- 5 Madhësia e valvulës
- 7 Forca e sustës
- 8 Presioni diferencial i lejuar
- 9 Temperatura e lejuar (°F)
- 10 Materiali i trupit
- 11 Koefficienti C_V ($K_{VS} \times 1.17$)
- 12 Kategoria ANSI (vlera e presionit)

Etiketa e të dhënave të aktuatorit



Versioni DIN/ANSI

- 1 Sipërfaqja efektive (DIN/ANSI)
- 2 Tipi
- 3 Konfigurimi (Var.-ID)
- 4 Numri ID
- 7 Madhësia e valvulës (DIN/ANSI)
- 9 Gama e pikës së caktuar (DIN/ANSI)
- 10 Materiali i diafragmës

Fig. 4: Etiketat e të dhënave

8 Shërbimi për klientin

Nëse ndodhin probleme se defekte, kontaktoni shërbimin e pas shitjes të SAMSON për ndihmë.

Adresat e SAMSON AG, filialeve, përfaqësuesve dhe ambienteve të shërbimeve të tij në të gjithë botën mund të gjenden në faqen e internetit të SAMSON, në të gjitha kataloget e produkteve SAMSON ose në pjesën e pasme të këtyre udhëzimeve për montimin dhe operimin.


Ju lutem dërgoni kërkesat tuaja në: service@samson.de

Për të ndihmuar me diagnostikimin, specifíkoni detajet e mëposhtme (shiko pjesën 7):

- Tipi dhe madhësia nominale e valvulës
- Numri i modelit dhe ID e konfigurimit (Var.-ID)
- Numri ose data e porosisë
- Presioni i rrjedhës së sipërme dhe rrjedhës së poshtme
- Temperatura dhe materiali i procesit
- Shpejtësia min. dhe maks. e rrjedhës në m³/h
- A është montuar sita?
- Vizatimi i instalimit që tregon vendin e saktë të rregullatorit dhe të të gjithë komponentëve shtesë të instaluar (valvulat e mbylljes, matës presioni, etj.)

9 Përmasat

Tipi 2422/2424 ·
I balancuar me një shakull




Përmasat në mm dhe peshat në kg · Vlerat në kllapa zbatohen për temperaturat nga 220 deri në 250 °C

Madhësia nominale		DN 125	DN 150	DN 200	DN 250
Gjatësia L		400 mm	480 mm	600 mm	730 mm
Lartësia H1		460 (600) mm	590 (730) mm	730 (870) mm	
Lartësia H2		145 mm	175 mm	235 mm	260 mm
Gamat e pikës së caktuar në bar	0.05 deri në 0.25	Lartësia H	990 (1130) mm	1120 (1260)	1260 (1400) mm
		Aktuatori	ØD = 380 mm, A = 640 cm ²		
	0.1 deri në 0.6	Lartësia H	990 (1130) mm	1120 (1260) mm	1260 (1400) mm
		Aktuatori	ØD = 380 mm, A = 640 cm ²		
	0.2 deri në 1.0	Lartësia H	990 (1130) mm	1120 (1260) mm	1260 (1400) mm
		Aktuatori	ØD = 380 mm, A = 640 cm ²		
	0.5 deri në 1.5	Lartësia H	910 (1050) mm	1040 (1180) mm	1180 (1320) mm
		Aktuatori	ØD = 285 mm, A = 320 cm ²		
	1 deri në 2.5	Lartësia H	910 (1080) mm	1070 (1210) mm	1180 (1350) mm
		Aktuatori	ØD = 285 mm, A = 320 cm ²		
Pesha ¹⁾ bazuar në gizë, PN 16, rreth					
0.05 deri në 1.0		135 kg	116 kg	286 kg	296 kg
0.5 deri në 1.5/1 to 2.5		125 kg	110 kg	280 kg	290 kg

¹⁾ +10 % për çelik të paoksidueshëm, hekur grafiti sferoidal dhe çelik i harkëtuar

Fig. 5: Përmasat · Tipi 2422/2424 · i balancuar me një shakull

Tipi 2422/2424 · I balancuar me një diafragmë



Dimensions in mm and weights in kg

Madhësia nominale	DN 125	DN 150	DN 200	DN 250
Gjatësia L	400 mm	480 mm	600 mm	730 mm
Lartësia H	720 mm	745 mm	960 mm	960 mm
Lartësia H2	145 mm	175 mm	260 mm	260 mm
Pesha (aktuatori me valvul), rreth				
0.05 deri në 1 bar	80 kg	93 kg	238 kg	248 kg
0.5 deri në 2.5 bar	75 kg	87 kg	232 kg	242 kg


Fig. 6: Përmasat · Tipi 2422/2424 · i balancuar me një diafragmë


10 Të dhëna teknike


Valvula e tipit 2422					
Presioni nominal		PN 16, 25 ose 40			
Madhësia nominale		DN 125	DN 150	DN 200	DN 250
Temperatura maks. e lejuar	Valvul e balancuar me një shakull	Izolim metalik: maks. 350 °C · Izolim i butë PTFE: maks. 220 °C · Izolim i butë EPDM ose FPM: maks. 150 °C · Izolim i butë NBR: maks. 80 °C ¹⁾			
	Valvul e balancuar me një diafragmë	Izolim i butë EPDM, maks. 150 °C			
Kategoria e rrjedhjes sipas IEC 60534-4		≤ 0.05 % e koeficientit K _{Vs}			
Aktuatori i tipit 2424					
Gamat e pikës së caktuar		0.05 deri në 0.25 bar · 0.1 deri në 0.6 bar · 0.2 deri në 1 bar 0.5 deri në 1.5 bar · 1 deri në 2.5 bar ²⁾			
Presioni maks. i lejuar në aktuator	Sipërfaqja efektive e diafragmës	320 cm ²		640 cm ²	
	Presioni	3 bar		1.5 bar	
Temperatura maks. e lejuar		Gazrat 350 °C, sidoqoftë, maks. 80 °C në aktuator ¹⁾ · Lëngjet 150 °C, me dhomë kondensimi, maks. 350 °C · Avull me dhomë kondensimi, maks. 350 °C			


¹⁾ Për oksigjen, maks. 60 °C

²⁾ Gamat e pikës së caktuar mbi 2.5 bar, shiko ► T 2552 · Valvul reduktimi presioni e tipit 2333











SAMSON AG · MESS- UND REGELTECHNIK
Weismüllerstraße 3 · 60314 Frankfurt am Main, Germany
Phone: +49 69 4009-0 · Fax: +49 69 4009-1507
samson@samson.de · www.samson.de

EB 2547 SQ

2017-08-30 · English